

Thirrja nga data 30.06.2025 deri në datën 07.07.2025

TERMAT E REFERENCES

PËR

TRAJNER/E PËR OFRIMIN E TRAJNIMIT ‘ZËRI YNË KA FUQI, AVOKIMI EFEKTIV PËR TË DREJTAT DHE NEVOJAT E FËMIJËVE’

Organizata	OJQ “NEVO KONCEPTI
Objektiva	Zhvillimi dhe ofrimi i trajnimit në temën “Zëri ynë ka fuqi, Avokimi efektiv për të drejtat dhe nevojat e fëmijëve” për anëtarët e Asamblesë Komunale të Fëmijëve (AKF) në Prizren.

OJQ “Nevo Koncepti” është organizatë joqeveritare e themeluar më 26 Nëntor 2014. Në themelimin e OJQ “Nevo Koncepti” kanë marrë pjesë intelektualë të komunitetit Romë të cilët për shumë vite janë angazhuar në forma të ndryshme dhe kanë kontribuar në fuqizimin dhe avancimin e pozitës së komunitetit Rom në pjesë të ndryshme të Kosovës sikurse në Prizren, Gjakovë, Ferizaj, Pejë, Rahovec, Fushë Kosovë, Suharekë etj.

OJQ “Nevo Koncepti” bashkëpunon me fëmijë, të rinjë dhe familje të komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian, me institucionet publike qendrore dhe lokale, organizata të shumta vendore dhe ndërkombëtare, media dhe palë tjera me interes.

OJQ Nevo Koncepti nga viti 2022 të muajit Qershor ka filluar të zbatojë projektin “Qeverisja e të Drejtave të Fëmijëve” në Komunën e Prizrenit, asambleja përbëhet nga 45 antarë të cilët përfaqësohen nga 13 shkollat e mesme të ulëta të komunës së Prizrenit. Në Asamblenë Komunale të Fëmijëve janë të përfshirë komunitetet Rom, Shqiptar, Turk, Boshnjak, Ashkali dhe Egjiptian, gjithashtu në Asamblenë Komunale të Fëmijëve përfaqësohen edhe fëmijët me aftësi të kufizuara të cilët marrin pjesë në aktivitete të ndryshme të cilat organizohen nga antarët e Asamblesë Komunale të Fëmijëve.

Aktualisht OJQ “Nevo Koncepti” është duke zbatuar 5 projekte në fusha të ndryshme të cilat synin themelor kanë fuqizimin dhe përmirësimin e pozitës së komunitetit Romë, Ashkali dhe Egjiptian.

1. INFORMATA TË PËRGJITHSHMË RRETH PROJEKTIT

”Qeverisja e të Drejtave të Fëmijëve” është projekt i implementuar nga Nevo Koncepti në partneritet me Save the Children Kosova/o dhe financuar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (Sida). Qëllimi i projektit është avokimi për të drejtat e fëmijëve dhe ngritja e pjesëmarrjes së fëmijëve në vendimmarrje në nivel lokal gjatë hartimit të politikave dhe gjatë organizimit të ngjarjeve nga komuna e Prizrenit nëpërmjet krijimit të Asamblesë Komunale të Fëmijëve në nivel të komunës nga 13 shkollat fillore të mesme të ulëta të komunës së Prizrenit.

Asambleja Komunale e Fëmijëve të Prizrenit është krijuar në vitin 2017 dhe përbëhet nga 43 Asamblesitë të cilët përfaqësohen nga 13 shkollat. Asambleja ka për qëllim avokimin dhe mbrojtjen e të Drejtat të Fëmijëve.

2. OBJEKTIVA

Qëllimi i këtij trajnimi është të fuqizojë anëtarët e Asamblesë Komunale të Fëmijëve për të kuptuar në mënyrë të thelluar konceptin e avokimit dhe rolin e tyre si përfaqësues të zërit të fëmijëve në komunitet. Përmes këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të aftësohen të identifikojnë çështje që prekin të drejtat dhe mirëqenien e fëmijëve, të analizojnë nevojat për ndryshim, dhe të zhvillojnë strategji efektive për të avokuar në mënyrë të strukturuar dhe të fuqishme.

Trajnimi do t'i ndihmojë pjesëmarrësit të ndërtojnë aftësi praktike në hartimin e mesazheve avokuese, angazhimin me vendimmarrësit dhe përdorimin e mjeteve kreative (si fushata vizuale, rrjete sociale, apo nisma komunitare) për të ngritur zërin e tyre në mënyrë të përgjegjshme dhe me ndikim.

Nevo Koncepti kërkon një individë (trajnerë) për të ofruar dhe zhvilluar trajnimin një ditorë për fëmijët e Asamblesë Komunale të Fëmijëve, grup mosha e fëmijëve 12 – 15 vjeçar/e.

3. Kualifikimi i kandidatit/ës

Trajneri/ja duhet të ketë aftësitë dhe njohurinë të nevojshme vijuese:

- Diplomë pasuniversitare (preferohet niveli Master) Drejtimi Psikologji, Edukim ose Shkenca Shoqërore.
- 5-7 vjet përvojë pune si trajner/e, duke përfshirë hartimin moduleve të trajnimit dhe ofrimin e programeve
- Shkathtësi të mira komunikimi, organizative, të punës interaktive dhe qasje mësimore adaptive dhe dinamike për të siguruar që të mësuarit përshtatet nevojave të pjesëmarrësve
- Njohuri dhe shkathtësi për të komunikuar dhe punuar me fëmijë dhe të rinj
- Kreativ, i/e hapur, motivues dhe që pranon sugjerimet;
- Respekton afatet kohore
- Të jetë fleksibil për tu përshtatur me orarin e përfaqësuesve të Asamblesë Komunale të Fëmijëve (AKF), për të caktuar ditën e trajnimit.
- Të jetë i/e aftë në komunikim me fëmijët, t'i mësoj dhe këshillojë fëmijët mbi temën.
- Të punojë në përputhje me politikat e Nevo Konceptit sa i përket respektimit të të drejtave të fëmijëve.
- Të ketë ekspertizë mbi temën e lartëcekur (kandidatët preferohet të kenë qertifikime mbi temën)
- Udhëheqë trajnimin me profesionalizëm, sqarojë dhe shtjellojë tematikën dhe termet përkatëse në pajtim me 9 rregullat për pjesëmarrje të sigurt dhe kuptimplotë të fëmijëve: <https://resourcecentre.savethechildren.net/document/nine-basic-requirements-meaningful-and-ethical-childrens-participation/>

Të punojë në përputhje me politikat e Nevo Konceptit, sa i përket Politikës për mbrojtjen e fëmijëve mbi respektimin e të drejtave të fëmijëve.

4. AFATI KOHOR

Puna duhet të filloj me 08 Korrik 2025. Raporti duhet dorëzuar në gjuhën shqipe në përfundim të punës.

Numri i rezultatit	Tituli i rezultatit	Përshkrimi	Ditët e punës	Data e rezultatit
1	Përgatitja e programit të trajnimit	Zhvillimi / adaptimi i programit të trajnimit, përfshirë materialet e trajnimit, si dhe të formojë vlerësimin Pre Post Test për “Zëri ynë ka fuqi, Avokimi efektiv për të drejtat dhe nevojat e fëmijëve”	2	Korrik 2025
2	Ofrimi i programit të trajnimit për Asamblenë Komunale të Fëmijëve	Ofrimi i trajnimit 1-ditor për një grup të pjesëmarrësve	1	Korrik 2025
3	Dorëzimi i raportit përfundimtar mbi angazhimin	Hartimit i raportit përfundimtar mbi angazhimin në trajnimin “Zëri ynë ka fuqi, Avokimi efektiv për të drejtat dhe nevojat e fëmijëve”	1	Korrik 2025
	Gjithsej:		4	

5. REZULTATET E PRITSHME

- Rritja e njohurive të anëtarët e Asamblesë Komunale të Fëmijëve rreth konceptit të avokimit, rolit të tyre si zëdhënës të fëmijëve dhe rëndësisë së pjesëmarrjes aktive në vendimmarrje.
- Përvetësimi i aftësive praktike nga pjesëmarrësit për të identifikuar çështje që prekin fëmijët në komunitet dhe për të zhvilluar ide konkrete për fushata ose nisma avokuese.
- Angazhim më i madh i pjesëmarrësve për të qenë aktivë në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të bashkëmoshatarëve të tyre përmes mënyrave të ndryshme të avokimit: takime, media sociale, aktivitete publike, etj.
- Përmirësimi i aftësive të komunikimit, të mendimit kritik dhe të punës në grup ndërmjet pjesëmarrësve, duke kontribuar kështu në një Asamble më të fuqizuar, të organizuar dhe të vetëdijshme për ndikimin e saj.
- Frymëzimi për veprim duke nxitur fëmijët të jenë model pozitiv për bashkëmoshatarët e tyre dhe të promovojnë një kulturë të suksesit dhe mbështetjes reciproke.

PROCEDURA E APLIKIMT

Të gjithë të interesuarit duhet t'i dërgojnë këto dokumente:

- a) CV.
- b) Metodologjia e propozuar e mbajtjes së trajnimit.
- c) Dy (2) referencë.
- d) Dokument i cili dëshmon që aplikuesi/ja nuk është nën hetime.
- e) Oferten Financiare Bruto

Aplikimi duhet të dërgohet **jo më larg se data 07.07.2025** në prokurimi@nevokoncepti.org